

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“ RENT & EXPLORE ALBANIA ” SH.P.K

Sot, më date 20 shtator te vitit dymije e njezete e një , në Tiranë,
Z. Erion Aga, atësia Ismail, amësia Servete, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Agallareve 03910005; Nd. 23; H. 1; Farkë; Farkë E Madhe; 1045; Tiranë, lindur më 29/06/1989, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 028094449 dhe nr. personal I90629065J.

Ka vendosur themelimin e shoqërisë “**RENT & EXPLORE ALBANIA**“ Sh.P.K, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “**RENT & EXPLORE ALBANIA**” SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar . Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare perfaqesimi dhe agjenci në shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2
Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **RENT & EXPLORE ALBANIA** SH.P.K

NENI 3
Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë në fushat:

Aktivitet ne fushen e qiradhenies se mjeteve motorike, makina, autovetura, etj

Aktivitet ne fushen e shit-blerjes se pasurive te luajteshme si automjete, autovetura,si te perdorura dhe te reja.

Aktivitet ne fushen e shit-blerjes se pjeseve te kembimit per automjete, si te perdorura dhe te reja. Servis dhe sherbimi riparimi.

Aktivitete ne fushen e turizmit, transport mallarash dhe pasagjeresh.

Import Eksport.



NENI 4
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Rr. Haxhi H.Dalliu, Pallati Alva-Konstruksion, D-4, Tiranë, Shqipëri.

NENI 5
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën **100.000 (njëqindmije) lek**.

Kapitali është i ndarë në një kuotë me vlerë nominale 100.000 (njëqindmijë),që zotërohet në masën 100% nga **Z. Erion Aga**, në cilësinë e ortakut të vetëm themelues.

NENI 6
Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor mbi 10 vjet .

Afati i aktivitet fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në QKR .

Aktivitete tregtare mbyllet në datën 31 dhjetor të çdo viti.

Aktiviteti i parë tregtar do të mbyllet në datën 31 dhjetor 2021 .

NENI 7
Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve ;
2. Administratori

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërisëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë do të jete Z.Erion Aga, i datëlindjes 29.06.1989, lindur në Tirane , banues në adresën, me adresë Agallareve 03910005; Nd. 23; H. 1; Farkë; Farkë E Madhe; 1045; Tiranë,

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori , i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm .

Kur administrimi i shoqërisë mund ti besohet disa personave, akti i emërimit vendos në alternative që:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8



Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhvendosin Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortaku themelues dhe të legalizohet përpara noterit ditën e themelimit, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortaku i Shoqërisë, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt i Themelimit hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga Ortaku Themelues i cili e gjeti atë në përputhje me vullnetin e tij të lirë e nënshkruan pa vërejtje me vullnet te plote .

**ORTAKU
THEMELUES I SHOQERISE
“ RENT&EXPLORE ALBANIA” SHPK**

ERION AGA
